

Si duhet të përgjigjem?

Kur heshtjen e një dite të zakonshme aktiviteti në Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Tiranë, e ndërpret zilja e telefonit, mua më fillon shqetësimi – edhe një tjetër kërkesë për karrige me rrota

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri



Marita Sopi

Mbeshtetje për personat me aftësi të kufizuar në rajonin e Shkodrës

Drafti i ripunuar i statusit të 1997, pas 10 vjetësh do të paraqitet në grupet parlamentare, ministritë përkatëse dhe Këshillin e Ministrave



ANAD do të ofrojë trajnimet e para për 20 interpretët e ardhshëm. Personat që nuk dëgjojnë do të ndjekin edhe lajmet në televizion

Apeli, në gjykata e spitale të ketë interpretë të gjuhës së shenjave për personat që nuk dëgjojnë

Personat që nuk dëgjojnë kanë nevojë të ndryshme, por në mungesë të interpretëve komunikimi me botën është i vështirë. Në një moment të vetëm që një person që nuk dëgjon shtrohet në spital, komunikimi me mjekun është shumë i vështirë.

Në këtë numër

Si duhet të përgjigjem

Faqe 3

Promovimi dhe mbrojtja e te drejtave te personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi

Faqe 4

Drafti i ripunuar i statusit të 1997, pas 10 vjetësh do të paraqitet në grupet parlamentare, ministritë përkatëse dhe Këshillin e Ministrave

Grupimi i shoqatave: Eshte domosdoshmeri statusi për aftësinë e kufizuar mendore

Faqe 6

“Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara”

Gararanci në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve

Faqe 8

Rasti ligjor

A.L është me aftësi të kufizuar në lëvizje, 17 vjeçe, banuese në një nga lagjjet periferike të Tiranës në Laprakë. Prej vitit 1998 ka migruar nga qyteti i Tropojës drejt Tiranës së bashku me familjen e saj.

Fq 12

ANAD do të ofrojë trajnimet e para për 20 interpretët e ardhshëm. Personat që nuk dëgjojnë do të ndjekin edhe lajmet në televizion

Faqe 14

Mbeshtetje për personat me aftësi të kufizuar në rajonin e Shkodrës
Interviste me znj. Marita Sopi, koordinatore e Qendres se Shanseve te Barabarta, Shkoder, program i FSHDPAK

Faqe 15

Fatjona ne shkolle, si gjithe te tjeret...

Faqe 17



Sfida 24

Revistë e përtremuajshme

Financuar nga:

Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Swedish Helsinki Committee

for Human Rights

Bashkëpunëtorë:

Bardhylka KOSPIRI

Narbis BALLHYSA

Entila ZYBA

Brikena DEMIRAS

Nasi DUKA

Zela KOKA

Bashkim SEITI

Veip PRODA

Edlira GRABOVA

Shoqata e të verbërve të Shqipërisë

Design and Layout

Grafika ELZANA

Adresa:

Rr.: “A.Z.Çajupi”, (Bogdani),
Pallatet e reja “ENIL”, K.3
Tiranë

Tel.: +355 4 269426;

E-mail: adrf@icc.al.eu.org

www.adrf.org.al

www.adrf.org.al

Si duhet të përgjigjem?



Kur heshtjen e një dite të zakonshme aktiviteti në **Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar** në Tiranë, e ndërpret zilja e telefonit, mua më fillon shqetësimi – edhe një tjetër kërkesë për karrige me rrota, nga një rreth në veri të Shqipërisë, që unë duhet t'i përgjigjem negativisht: “më vjen keq, por nuk mund ta plotesojmë kërkesën tuaj sepse për mungesë fondesh, **prodhimi është i kufizuar dhe lista në pritje është e gjatë**”.

Megjithatë zëri kembëngulës vazhdon : Jo moj motër, unë dua një nga ato karriget e thjeshta për djalin tim që të zëvendësojë karrigen që kam porositur tek ju, para disa vitesh në punishten “Mirësia“, sepse tashmë ai është rritur dhe përmasat e tij kanë ndryshuar, ai dhe ne tashmë të mësuar me përdorimin e karriges, nuk mund të bëjmë dot pa të”. **Si t'i përgjigjesha ?**

Telefonata dhe zëra të tillë me kërkesën për t'u pajisur me karrige me rrota, më kanë shoqëruar gjatë gjithë viteve të pranisë time në këtë zyrë. Kanë qenë persona me aftësi të kufizuar të çdo moshe, të ardhura nga të gjitha rrethet e Shqipërisë që kanë kërkuar një

karrige me rrota për të lehtësuar jetën e përditëshme të tyre dhe të familjarëve të tyre; kanë qenë kryetarë shoqatash të aftësisë së kufizuar që kanë dashur të pajsin anëtarët e shoqatave të tyre me këtë mjet të domosdoshëm; kanë qenë dhurues të ndryshëm (te vendit dhe të huaj) që kanë porositur karrige me rrota duke sponsorizuar prodhimin e tyre dhe në të njëjtën kohë duke bërë të mundur kështu edhe vazhdimin e punës të punëtorëve të këtij reparti ndërmjet tyre edhe me përdorues të karriges me rrota); dhe për dy vjet me rradhë kërkesat kanë ardhur edhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që kundrejt një fondi të akorduar nga qeveria plotësoi nevojat e një pjese të invalidëve

të punës, përdorues të karriges me rrota.

Dhe të gjithë kanë marrë përgjigje korrekte, në kohën e duhur dhe sipas specifikave përkatëse.

Por si duhet të përgjigjem tani?**Si duhet t'u përgjigjem** listës me 900 emra që presin të pajisen me karrige me rrota ?

A do të kem guximin t'u them se punishtja “Mirësia“ për mungesë fondesh do të mbyllet dhe ata do duhet t'i drejtohen tregut të lirë, ku shpesh here edhe ndihmat shiten ?

A do të kem guximin t'u them se disa përfaqësues dhe drejtues të shoqatave të tyre, persona me



aftësi të kufizuar, që tashmë kanë pajisur vehten dhe familjarët e tyre me karrige më të shtrenjta elektrike dhe me automjete të markave të ndryshme për të cilat shteti i ka ndihmuar t'i përfitojnë dhe përdorin në kushte lehtësuese, harrojnë se ka shumë më tepër persona me aftësi të kufizuar të shpërndarë në Shqipëri, që nuk pretendojnë për një luks të tillë, por duan karrige me rrota thjesht që duke vënë në lëvizje krahët e tyre të mos jenë barrë e familjes për nevojat e përditëshme? **A do të kem guximin** t'u them punëtorëve me aftësi të kufizuar të punishtes "Mirësia" se për mungesë fondesh ajo do të mbyllet dhe ata do të humbasin punën, modelin e vetëm të punësimit të mbrojtur me të cilën çdo qeveri mund të mburrej?

A do të më kuptojnë, kur t'u them se punishtja do të mbyllet, donatorët, punëtorët e kompanise hollandeze NUON që dhuruan pagën e një dite pune të tyre për të ndërtuar dhe pajisur me makineri repartin e prodhimit të karrigeve me rrota?

E ulur në karrigen time me rrota, prodhim i punishtes "Mirësia" e vitit 2002, një nga 2100 karriget e prodhuara prej saj dhe që ka përballuar lëvizjen jo normale në trotualet e papërshtatur të Tiranës, ka ngjitur shkallë në fushata ndërgjegjësuere drejt zyrave të institucioneve që përgjigjen e punojnë për aftësinë e kufizuar, unë do të vazhdoj të pres telefonata edhe me kërkesat për karrige me rrota, por përgjigjen e shqetësimit tim

"Si t'u përgjigjem" tashmë di se ku ta kërkoj:

Janë institucionet përgjegjëse shtetërore ato që duhet jo vetëm të mbështesin e zhvillojnë më tej aktivitete të tilla duke ofruar legjislacionin e duhur dhe mbështetjen financiare, por duhet të programojnë zgjerimin dhe shtrirjen më të gjerë të tyre, në mënyrë që angazhimin e ndërtimit të një shteti social që krijon shanse të barabarta edhe për personat me aftësi të kufizuar, ta bëjnë sa më shpejt realitet.

Bardhylka Kospiri
Koordinatorë e programit
te avokatisë/FSHDPAK
Përdoruese e karriges me
rrota



Promovimi dhe mbrojtja e te drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri

USAID – SHBA, do të mbeshetese aktivitetin e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK), të fokusuar në promovimin dhe mbrojtjen e te drejtave të personave me aftësi të kufizuar (PAK), duke nxitur

permiresimin dhe implemtenimin e kuadrit ligjor dhe politikave për aftësinë e kufizuar me ane të krijimit të një instrumenti për monitorimin e tyre të vazhdueshem. FSHDPAK ka qene promotore e idese për një Strategji Kombetare për Aft-

esine e Kufizuar (SKAK); duke qene e vetedijshme se aprovimi i SKAK nga Keshilli i Ministrave në janar 2005 ishte vetem hapi i pare, FSHDPAK ka si qellim që nepermjet ketij programi të nxise implementimin e strategjise nga strukturat përgjegjese.

Programi do të ketë si qëllim përmirësimin e qendrimeve të agjensive/strukturave perkatese qeveritare apo jo-qeveritare, hartuesve të politikave dhe të gjithë shoqërisë duke promovuar SKAK në nivel kombëtar dhe lokal; të rrisë kapacitetet e OJF të fushës së aftësive të kufizuar dhe të gjithë aktorëve perkates duke ofruar trainime, ekspertize teknike dhe konsulencë nga profesioniste vendas, rajonale apo ndërkombëtare në fushën e aftësive të kufizuar, të rrisë nivelin e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë duke hartuar raporte monitoruese vjetore si një instrument i disponueshëm për monitorimin e implementimit të SKAK, duke ngritur rrjetë të zgjeruara për të çuar më tej dhe për të përfshirë aftësinë e kufizuar në agjendat e tjera avokative dhe reformash duke sfiduar përjashtimin dhe nderhyrjen fragmentare dhe duke promovuar një shoqëri gjithëpërfshirëse.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (FSHDPAK), në kuadër të programit: “Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në Shqipëri”, gjatë periudhës Shkurt – Prill 2007 organizoi në qytetet e Elbasanit, Korçës, Vlores, Shkodrës, Durrësit dhe Tiranës seminarët me temë: “**Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, Prioritetet, Monitorimi i zbatimit të tyre**”. Seminarët patën për qëllim evidentimin e prioriteteve që kjo strategji ka vendosur për zbatimin e të



Pjesmarrja e shumë aktorëve në këto seminare shërbeu për të krijuar një tablo realiste të situatës aktuale të personave me aftësi të kufizuar perkatesisht në këto rajone dhe sfidat me të cilat ata ndeshen në jetën e përditshme.

drejtave të personave me aftësi të kufizuar për shërbime shëndetësore e sociale, arsim, punësim, përshtatshmeri si dhe të benin një pasqyrë të monitorimit të nisur nga FSHDPAK për zbatimin e këtyre prioriteteve respektivisht për çdo fushë.

Prezantimet e bëra gjatë këtyre seminareve u pritën me shumë interes nga pjesëmarrësit, përfaqësues nga institucione lokale përgjegjëse për problematiken e aftësive të kufizuar, shoqëri civile, duke krijuar mundësi për një debat të hapur në drejtim të ballafaqimit të prioriteteve të vendosura nga SKAK përmes planit të veprimit si dhe mundësi konkrete për zbatueshmëri të tyre në nivel lokal.

Pjesmarrja e shumë aktorëve në këto seminare shërbeu për të krijuar një tablo realiste të

situatës aktuale të personave me aftësi të kufizuar perkatesisht në këto rajone dhe sfidat me të cilat ata ndeshen në jetën e përditshme. Për problematiken e tillë si arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar, shërbimet sociale dhe shëndetësore/rehabilituese, punësimi, përshtatshmeria ndërtimore pjesëmarrësit u shprehën për domosdoshmerinë e hartimit të planeve konkrete nga pushteti lokal për ofrimin e alternativave për zgjidhje të tyre shoqëruar dhe me buxhete perkatese.

Megjithatë përfaqësues të pushtetit lokal në këto seminare u angazhuan për marrje të përgjegjësisë të njohura nga ligji u evidentua fakti që nevojitet një koordinim dhe vlerësim paralel i prioriteteve për këto problematika në të dy nivelet qendrorë dhe atë lokal.

Njekohesisht ne kuader te ketij programi ka nisur studimi per monitorimin e SKAK ne rajonet ku programi eshte i fokusur. Ketij qellimi i ka sherbyer krijimi i infrastruktures se nevojshme;

perdoret per realizimin e studimit. Aktiviteti per realizimin e studimit ka nisur ne nivel lokal dhe do te finalizohet me nje raport te detajuar i cili do te behet publik ne Shtator 2007.

monitorimin e aktoreve pergjegjes per implementimin e SKAK , permes impakteve konkrete dhe rekomandimeve te bazuara do te influencojne ne nxitjen e strukturave pergjegjese



grupi i eksperteve ne nivel qendror per secilen fushe(arsim, pershtatshmeri, sherbime shendetesore, sociale dhe punesim), grupet e eksperteve ne nivel lokal perkatesisht ne rajonet ku programi eshte i fokusur, hartimi i metodologjise e cila do te

Mbeshtetur ne qellimin dhe objektivat e programit eshte ndertuar nje plan veprimi ne afate kohore. Programi "Promovimi dhe Mbrojtja e te Drejtave te Personave me Aftesi te Kufizuar "i pari i ketij lloji ne ndergjegjesimin dhe ne te njejten kohe

per plotesim te detyrimeve te percaktuara ne kete dokument duke promovuar mbrojtjen e te drejtave te personave me aftesi te kufizuar ne Shqiperi.

Narbis Ballhysa
Koordinatori Programi/
FSHHPAK

Drafti i ripunuar i statusit të 1997, pas 10 vjetësh do të paraqitet në grupet parlamentare, ministritë përkatëse dhe Këshillin e Ministrave

Grupimi i shoqatave: Eshte domosdoshmeri statusi për aftësinë e kufizuar mendore

Shoqatat në mbrojtje të aftësisë së kufizuar mendore bashkohen nën një zë të vetëm, për të kërkuar fuqimisht miratimin e një statusi të veçantë për njerëzit me aftësi të kufizuar mendore. Grupi më i madh i njerëzve me aftësi të kufizuar në vendin tonë është më i diskriminuar nga pjesa tjetër, për

shkak edhe të pamundësisë për t'u bërë ballë problemeve. Shoqatat kanë riformuluar statusin i cili fle prej më shumë se 10 vjet në sirtaret e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe do ta paraqesin për herë të fundit para politikëbërësve. Në forumin tonë, përfaqësues të shoqatave rrëfejnë luftën e tyre

për zgjidhjen e këtij problemi, që është edhe një detyrim për shtetin.

BARDHYLKA KOSPIRI,
ZYRA AVOKATORE PRANË
FSHHPAK

Pse është i nevojshëm një status i veçantë për personat me aftësi të

Tashmë Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në përgjigje të situatës së mosvazhdimin të punës së strukturave shtetërore për t'i dhënë zgjidhje situatës diskriminuese brenda grupimeve të aftësisë së kufizuar, ka ndërmarrë nismën për mbrojtjen ligjore të këtij grupimi dhe ka filluar një fushatë avokatie e lobimi, duke mbështetur ngritjen dhe funksionimin e grupimit të Shoqatave të Prindërve të Personave me Aftësi të Kufizuar Mendore



kufizuar mendore?

E parë nën këndvështrimin e të drejtave është një diskriminim brenda grupimeve të aftësisë së kufizuar mungesa e statusit për personat me aftësi të kufizuar mendore. Për më tepër duke qenë se janë grupimi rreth të cilit janë më të pranishme dhe më të shumta paragjykimet dhe ato ndeshen kudo, miratimi i shpejtë i statusit të tyre tregon se strukturat shtetërore nuk janë në vetvete bartëse të këtyre paragjykimëve dhe respektojnë barazisht dhe realisht të drejtat e njeriut.

Pse janë lënë jashtë vëmendjes së shtetit?

Faktet flasin se grupimet e tjera të aftësisë së kufizuar, vetë personat me aftësi të kufizuar, janë përpjekur shumë që të përfitojnë statutet e tyre, me forcat e tyre. Duke qenë se vetë personat me aftësi të kufizuar mendore nuk mund të mbrojnë vetveten, janë prindërit e tyre që i përfaqësojnë. Jo se nuk ka pasur përpjekje nga shoqatat e

prindërve, por ato, ndër të tjera, nuk kanë pasur forcën dhe angazhimin e duhur, për faktin se problemet e fëmijëve me aftësi të kufizuar mendore kërkojnë nga prindërit shumë angazhim dhe përkushtim, krahas problemeve të tjera në familje duke mos u lënë kohën dhe mundësitë e nevojshme për të luftuar për të drejtat e tyre. Të gjitha këto përballë një strukture shtetërore, vazhdimisht në ndryshim në kushtet e tranzicionit, që nuk ka marrë sa duhet përgjegjësitë e saj.

Çfarë hapash do të ndiqni duke u nisur se që prej 10 vitesh flitet për një status të tillë dhe nuk është marrë asnjë masë, madje është përfolur se do të kishte një ligj integral, për të cilin qeveria nuk po merr asnjë zhvillim?

Tashmë Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në përgjigje të situatës së mosvazhdimin të punës së strukturave shtetërore për t'i dhënë zgjidhje situatës

diskriminuese brenda grupimeve të aftësisë së kufizuar, ka ndërmarrë nismën për mbrojtjen ligjore të këtij grupimi dhe ka filluar një fushatë avokatie e lobimi, duke mbështetur ngritjen dhe funksionimin e grupimit të Shoqatave të Prindërve të Personave me Aftësi të Kufizuar Mendore, për realizimin e kërkesës së tyre për të qenë në një nivel përfitimi ligjor të barabartë me grupimet e tjera duke përfitur një status të tyre.

A jeni dakord me një ligj integral për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara?

Pajisja me status e personave me aftësi të kufizuar mendore është vetëm hapi kalimtar për t'i vënë ata në të njëjtin stad vlerësimi dhe përfitimi si të gjithë grupimet e tjera. Por hartimi i një ligji integral duhet të jetë hapi i mëtejshëm për zgjidhjen e problematikave të larmishme të aftësisë së kufizuar, në kushtet e zhvillimit të sotëm të shoqërisë shqiptare.

NASI DUKA,
PRESIDENTI I
PËRGJITHSHËM I
"SHOQATËS NË NDIHMË
TË HANDIKAPËVE
MENDORË TË SHQIPËRISË"

Pse është i nevojshëm një status i veçantë për personat me aftësi të kufizuara mendore?

Shoqata jonë e shtrirë në 31 rrethe të vendit përfaqëson mbi 40 mijë persona me aftësi të kufizuara mendore, për shkak të aftësive të zhvillimit të tyre mendor. Statusi është dorëzuar më 15 nëntor të 1997. Personalisht bashkë me kryesinë ekzekutive të Shoqatës Kombëtare e kam ndjekur hap pas hapi miratimin e statusit të personave me aftësi të kufizuara mendore. Si konkluzion unë nxjerr papërgjegjshmëri, mosvëmendje e shtetit, e qeverisë ndaj kësaj kategorie njerëzish që janë pjesa më e dhimbshme e shoqërisë.

Pse janë lënë jashtë vëmendjes së shtetit?

Këta persona diskriminohen edhe brenda llojit të tyre. Në këtë kuadër, ne me çdo ministër të radhës kemi bërë takimet e nevojshme dhe të gjithë ministrat kanë treguar vullnetin e mirë dhe predispozicionin e tyre për ta miratuar, por deri tani ky status ka mbetur vetëm në sirtare dhe nuk është miratuar. Shkaku është edhe nxjerrja e pretendimeve të ndryshme. Ky projektstatus ka 17 nene të cilat ne i kemi propozuar dhe ka një kosto financiare.

Çfarë hapash do të ndiqni duke u nisur se që prej 10



Ne dëgjojmë që edhe gjuetarët kanë një status e jo më kjo kategori njerëzish që i përket shoqërisë sonë. Ne do t'i përdorim të gjitha mundësitë tona. Shoqëria sot është e ndjeshme ndaj kësaj kategorie, por mjerë një familje që ka një person me aftësi të kufizuara mendore.

vitesh flitet për një status të tillë dhe nuk është marrë asnjë masë, madje është përfolur se do të kishte një ligj integral, për të cilin qeveria nuk po merr asnjë zhvillim?

Kohët e fundit ne jemi bashkuar të gjitha shoqatat që përfaqësojnë këtë kategori njerëzish dhe kemi krijuar një lobing dhe kemi marrë takime të herëpashershme. Së fundi, dorëzuar një draft të statutit edhe te Avokati i Popullit, të përfunduar dhe të korrigjuar për faktin edhe sepse kushtet kanë ndryshuar dhe kërkesat kanë ndryshuar. Ne po e ndjekim hap pas hapi dhe do t'ia çojmë më pas grupeve parlamentare, ministrive përkatëse dhe Këshillit të Ministrave. Shpresoj se me nismën tonë do të gjejë miratim, edhe nëpërmjet sensibilizimit që ne po bëjmë. Natyrisht edhe ne do të

përdorim mjetet demokratike.

A jeni dakord me një ligj integral për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara?

Po natyrisht. Ne dëgjojmë që edhe gjuetarët kanë një status e jo më kjo kategori njerëzish që i përket shoqërisë sonë. Ne do t'i përdorim të gjitha mundësitë tona. Shoqëria sot është e ndjeshme ndaj kësaj kategorie, por mjerë një familje që ka një person me aftësi të kufizuara mendore.

ZELA KOKA,
MEDPAK, LIBRAZH

Pse është i nevojshëm një status i veçantë për personat me aftësi të kufizuara mendore?

Duke qenë se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe për format e tjera të aftësisë së kufizuar ka akte ligjore e

nënligjore, për përfitime nga shkaku i aftësisë së kufizuar personat me aftësi të kufizuar mendore edhe pse janë grupi më i madh dhe në gjendje më të rëndë janë të diskriminuar duke qenë se për këtë kategori nuk ka një status të trajtimit të tyre.

Pse janë lënë jashtë vëmendjes së shtetit?

Mendohet se kjo kategori nuk është në gjendje për shkak të aftësisë së kufizuar mendore të mbrojtë vetë të drejtat e tyre. Për këtë ata mbrohen nga shoqatat e prindërve dhe duke qenë se prindërit kërkojnë në vazhdimësi një të drejtë me dinjitet dhe pa përdorur format e ndryshme të presionit aktiv mentaliteti është se organet përgjegjëse më shumë janë të prirura të zgjidhin problemet për ata që bëjnë më shumë zhurmë se sa për ata që kërkojnë me format e njohura. Një shkak tjetër mendohet se është se duke qenë një grup i madh që kap rreth 70 për qind të personave me aftësi të kufizuar organet përgjegjëse të shtetit nuk duan të përballojnë faturën financiare duke diskriminuar padrejtësisht këtë kategori.

Çfarë hapash do të ndiqni duke u nisur se që prej 10 vitesh flitet për një status të tillë dhe nuk është marrë asnjë masë, madje është përfolur se do të kishte një ligj integral, për të cilin qeveria nuk po merr asnjë zhvillim?

Në kuadrin e afirmimit të MSA do të sensibilizohen organizmat evropiane për shkeljen e të

Në kuadrin e afirmimit të MSA do të sensibilizohen organizmat evropiane për shkeljen e të drejtave të njohura me kushtetutë nga një vend që ka aplikuar për të qenë pjesë integrale e Evropës.

drejtave të njohura me kushtetutë nga një vend që ka aplikuar për të qenë pjesë integrale e Evropës.

A jeni dakord me një ligj integral për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara?

Ne vazhdimisht kemi parashtruar që do të ishte më mirë një ligj integral të cilin strukturat prej 10 vitesh e kanë premtuar. Por kjo ka ndodhur si me mitin e Sizifit. Kur ne si grup arrinim të dërgonim deri në instancat e dikasterit të Punës dhe Çështjeve Sociale këtë ndërroreshin ministrat e zëvendësministrat dhe kështu gjithçka fillonte nga e para. Po kështu ndodhte edhe kur ndërroreshin kabinetet politike. Kjo është një nga arsytet se përse strukturat qeveritare prej 10 vitesh vetëm premtojnë dhe nuk bëhet asgjë sepse ne kemi kërkuar që në vend të ligjeve të veçanta duke u nisur nga një standard i barabartë për të gjitha kategoritë të ketë një ligj integral. Në ligjin integral kërkohet një trajtim i barabartë për të gjithë aq sa janë mundësitë dhe jo një ndarje sipas kategorive duke diskriminuar një palë që është edhe me gjendje më të rëndë.

**VEIP PRODA,
SHOQATA "MBROJTJA,
INTEGRIM DHE
SOCIALIZIMI I ARTISTËVE
ME AFTËSI TË KUFIZUARA"**
Pse është i nevojshëm një

status i veçantë për personat me aftësi të kufizuar mendore?

Personat me aftësi të kufizuar mendore janë segmenti më i diskriminuar ndonëse përbëjnë mbi 70 për qind të numrit të përgjithshëm të tyre. Kjo ka ardhur për faktorë subjektivë, por që janë të lidhur edhe me interesa politike dhe nën justifikimin se kjo lidhet me një faturë shumë të lartë ekonomike, gjë që është e papranueshme. Ka një rregull në të gjitha vendet demokratike, ku legjislacioni miratohet dhe pastaj shoqërohet me akte nënligjore, të cilat zgjidhen shkallë-shkallë. Ne kërkojmë që personat me aftësi të kufizuara mendore të bëhen të barabartë mes të barabartëve me segmentet e tjera të aftësisë së kufizuar që kanë staturë dhe pastaj të fillojë zbatimi i tyre, sepse edhe ata që kanë staturë nuk i kanë 100 për qind të realizuara.

Pse janë lënë jashtë vëmendjes së shtetit?

Ne kemi bërë një luftë jo të vogël, gati 10 vjet dhe çuditërisht ka justifikime nga më banalet. Këto janë të papranueshme për ne. Këta nuk mund të kërkojnë vetë, të tjerët mund të përplasnin dyert dhe tavolinat, kurse këta nuk mundin. Janë pjesa më e brishtë e shoqërisë shqiptare. Meqë këta nuk e bëjnë dot këtë gjë, ata bëjnë show, ikën një ministër dhe vjen një tjetër, po të njëjtat përgjigje kemi marrë ashtu si edhe para 10 vitesh.

Çfarë hapash do të ndiqni duke u nisur se që prej 10 vitesh flitet për një status të tillë dhe nuk është marrë asnjë masë, madje është përfolur se do të kishte një ligj integral, për të cilin qeveria nuk po merr asnjë zhvillim?

Tani kemi bërë një draft duke marrë parasysh të gjithë mendimet e shoqatave të aftësisë së kufizuar dhe do t'ia paraqesim edhe njëherë institucioneve përkatëse. Nëqoftëse nuk do të zgjidhet kjo në këtë rrugë demokratike, me thënë të drejtën do të zgjedhim rrugën ligjore, duke paditur qeverinë.

A jeni dakord me një ligj integral për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara?

Ka një gjë që ndoshta në vendin tonë nuk janë pjekur akoma kushtet për të bërë një ligj integral. Tani për tani duhet të bëhen të barabartë këta njerëz dhe më pas kategoritë të bëhen të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë.

BASHKIM SEITI,
SHOQATA "NDIHMONI
JETËN"

Pse është i nevojshëm një status i veçantë për personat me aftësi të kufizuar mendore?

Mungesa e një statusi të deritanishëm për këta persona është një mangësi dhe një paaftësi e shtetit shqiptar që nuk ka arritur ta bëjë këtë kategori me status. Nëse flitet për personat me aftësi të kufizuar mendore ku përfshihen edhe fëmijët, është fjala për një kategori jo të vogël, që kap

shifrën prej 35 mijë vetë, që ekziston edhe si shifër zyrtare deri tani. Më e domosdoshme është që këtyre njerëzve t'u jepet akses ashtu si edhe njerëzve të tjerë të shoqërisë. Por pengesat ndjehen gjithnjë e më shumë dhe lidhen me mungesën e këtij statusi. Një familje me persona me aftësi të kufizuar, ka nevojë që të marrë në natyrë ndihmë dhe lehtësi shoqërore. Nëse në statutet e tjera ekziston rimbursimi i energjisë elektrike dhe telefonit, është akoma e më e nevojshme për këta fëmijë, që kanë nevojë për ngrohje me energji, që mbi të gjitha ai të mbijetojë. Apo edhe për transportin urban publik, që nuk mund ta përdorin, pasi kërkesa është e barabartë me njerëzit e tjerë. Kjo është e padrejtë. Apo edhe për arsimin gjithëpërfshirës, megjithëse kanë dalë rregulla praktikisht nuk mund të realizohet, sepse s'ka transport, apo përshtatshmëri mjedisesh në shkollë. Ky është një diskriminim që i bëhet kësaj kategorie.

Pse janë lënë jashtë vëmendjes së shtetit?

Janë disa arsye. Shteti nuk është i interesuar të zgjidhë problemet që kanë një farë kosto dhe deri tani është mjaftuar me zgjidhjen e problematikave që i kanë shkuar në formë demonstrative ose me ndërhyrje miqësore. Një gjë është e vërtetë që fëmijët me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike kanë folur vetëm nëpërmjet zërit të prindërve. Kjo tregon se ne tani duhet të luftojmë që me këta persona të mos spekulohet më.

Çfarë hapash do të ndiqni

duke u nisur se që prej 10 vitesh flitet për një status të tillë dhe nuk është marrë asnjë masë, madje është përfolur se do të kishte një ligj integral, për të cilin qeveria nuk po merr asnjë zhvillim?

Kohët e fundit jemi organizuar në një rrjet shoqatash, së bashku me ADRIF që ka qenë gjithnjë mbështetëse në këtë fushë, kemi arritur të përpilojmë një projekt ide për këtë ligj, duke kërkuar që edhe Ministria e Punës, grupet parlamentare dhe vetë Parlamenti ta vlerësojnë. Ata kanë të drejtën e tyre për ta parë nga ana juridike, por ne do të dëshironim që të ishim pjesë e hartimit dhe miratimit të këtij ligji deri në fund, pasi pjesëmarrja jonë do ta ndihmonte shumë qeverinë dhe do të ishte në nderin e këtij Parlamenti që të zbatonte një nga pikat më të rëndësishme të Konventës së OKB-së, për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

A jeni dakord me një ligj integral për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara?

Nuk e shikojmë si gjë të pamundur, por mund të themi se bërja e një ligji integral do të ishte edhe më e mirë për të futur në fokus gjithë spektrin e aftësisë së kufizuar, aty ka edhe vend për të parë specifikat e tyre, duke mos prekur askënd dhe duke u dhënë mundësi dhe shanse të barabarta të gjithëve, për të marrë ndihmën e nevojshme, në përgjithësi dhe në veçanti për specifikat që kanë.

Brikena Demiras
gazetare

“STANDARDET E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA”

Gararanci në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve

Në fushën e aftësisë të kufizuar, muajt e fundit, është miratuar një dokument tjetër i rëndësishëm në mbrojtje dhe respektim të të drejtave të PAK. **Me VKM nr.822, datë 6.12.2006 janë miratuar “Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”.** Këto standarde mbështeten në paketën e Standardeve të Përgjithshme të Shërbimeve, miratuar me VKM nr.658 datë 17.10.2005. Standardet e përgjithshme përbëjnë dokumentin bazë për të gjitha standardet që janë hartuar deri tani si për fëmijët, të moshuarit, viktimat e trafikimit etj. Edhe standardet për personat me aftësi të kufizuara mbështeten në standardet e përgjithshme dhe si rezultat kanë pika takimi midis tyre. Por standardet për PAK zbërthejnë në mënyrë më të hollësishme rregullat, kriteret dhe rezultatet që duhet të zbatohen dhe arrihen në shërbimet rezidenciale dhe ditore për këtë grup.

Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për personat me aftësi të kufizuara, synojnë respektimin e parimeve të dokumenteve themelore, si: parimi i së drejtës civile, barazisë dhe mosdiskriminimit, i vetëvendosjes, i përfshirjes, i pjesëmarrjes dhe mundësive të

barabarta, i jetesës pa barriera dhe mjedisit të lirë, i rehabilitimit, parandalimit, identifikimit dhe trajtimit të hershëm të aftësisë së kufizuar, integritit shoqëror dhe pjesëmarrjes në jetën e komunitetit.

3. *Pavarësia, përfshirja dhe vetëvendosja.* Siguron që shërbimet e përkujdesjes mbulojnë nevojat funksionale jetike në përputhje me nevojat e moshës, si edhe nevojat fizike, psikologjike e sociale të

Miratimi i këtij dokumenti, ka sjellë si domosdoshmëri afishimin në të gjitha njësitë ku ofrohen shërbime rezidenciale dhe ditore, për të njohur përfituesit dhe të gjithë të interesuarit me standardet dhe kërkesat e tyre, standardet e përgjithshme dhe standardet specifike për PAK. Kjo do të ndikojë në orientimin më të mirë për ofruesit dhe përdoruesit e shërbimeve, në zbatim të kërkesave dhe rregullave që përcaktohen në këto standarde.

Standardet e PAK mbulojnë pesë fusha të rëndësishme për jetën e personave me aftësi të kufizuara, si:

1. *Pjesëmarrja në vendimmarrje lokale.* Me anë të këtij standardi sigurohet bashkëpunimi i strukturave lokale me personat me aftësi të kufizuar, familjarët e tyre dhe organizatat përfaqësuese për të parandaluar e shmangur diskriminimin dhe përjashtimin social të PAK.

2. *Vlerësimi dhe plani individual i shërbimit.* Ky standard thekson vlerësimin e PAK nga një ekip multidisiplinar që ngrihet nga organizata që merr përsipër dhënien e shërbimeve.

përfituesve. Shërbimet janë cilësore, ofrohen në kohën e duhur dhe u përgjigjen siç duhet kërkesave dhe nevojave të klientëve për mbështetje për një jetë sa më të pavarur në gjirin e shoqërisë.

4. *Proçedurat e shërbimeve.* PAK marrin shërbime profesionale, që ndjekin proçedura të rregullta të referimit, vlerësimit, planifikimit dhe ofrimit. Natyra multidisiplinare e shërbimeve realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me organizata e struktura të ndryshme. Përfituesit dhe përfaqësuesit e tyre janë tërësisht të përfshirë në këto proçedura.

5. *Trajtimi i barabartë dhe ankimi.* Ky standard ngre detyrimin për çdo ofrues për të hartuar kriteret të qarta për të drejtën e përfitimit të shërbimeve, si edhe procedura të monitorimit të zbatimit të këtij shërbimi. Gjithashtu klienti ose përfaqësuesi i tij kanë të drejtën e ankimit. Ankesat e tyre merren seriozisht dhe shoqërohen me veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes.

Bazuar në VKM nr.822 datë 6.12.2006, zbatimi dhe cilësia e standarteve do të jenë nën inspektimin e strukturave të Shërbimit Social Shtetëror. Vlerësimi i këtij inspektoriati do të shërbejë si dokument bazë, për MPCSSHB për të vlerësuar kapacitetet e ofruesve të

shërbimeve (rezidenciale apo ditore) lidhur me liçencimin e tyre.

Miratimi i këtij dokumenti, ka sjellë si domosdoshmëri afishimin në të gjitha njësitë ku ofrohen shërbime rezidenciale dhe ditore, për të njohur përfituesit dhe të gjithë të interesuarit me standardet dhe kërkesat e tyre, standardet e përgjithshme dhe standardet specifike për PAK. Kjo do të ndikojë në orientimin më të mirë për ofruesit dhe përdoruesit e shërbimeve, në zbatim të kërkesave dhe rregullave që përcaktohen në këto standarde.

Miratimi i një dokumenti kaq të rëndësishëm, shpresojmë se, do

të ndikojë jo vetëm në garantimin dhe respektimin e të drejtave të PAK në qendra rezidenciale dhe ditore, por edhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që sektori publik dhe ai privat duhet të ofrojë në fushën e shërbimeve shoqërore, e cila mbetet ende një nga më problematikat në fushën e aftësisë të kufizuar.

Në këtë kuadër FSHDPAK, në rolin e shoqërisë civile, me anë të programeve të saj, do të synojë në vazhdim monitorimin e këtij dokumenti me qëllim zbatimin dhe rritjen e cilësisë të shërbimeve nga çdo subjekt privat apo publik, në fushën e aftësisë të kufizuar.

**Entila Zyba
Avokate/ Koordinatore e
Programit ligjor pranë
FSHDPAK**

Duke patur parasysh kërkesat e shumta të përfituesve të FSHDPAK për shpjegime ligjore po japim me poshte disa raste ligjore të trajtuara nga zyra në Tiranë dhe në rrethe.

Rasti ligjor

TIRANË

A.L është me aftësi të kufizuar në lëvizje, 17 vjeçe, banuese në një nga lagjet periferike të Tiranës në Laprakë. Prej vitit 1998 ka migruar nga qyteti i Tropojës drejt Tiranës së bashku me familjen e saj. Prej vitit 1994 trajtohet me pagësën e aftësisë të kufizuar bazuar në ligjin e kohës nr.7710 date 18.05.1993 "Për ndihmen dhe perkujdesjen shoqërore"



shfuqizuar me ligjin Nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”. A.L kishte dëgjuar se bazuar në legjislacionin në fuqi mund të përfitonte 2-fishin e pagesës së aftësisë së kufizuar, në rast se frekuentonte sistemin parauniversitar (shkollën e mesme). Në këto kushte ajo ju drejtuar Programit ligjor të FSHDPAK, për të marrë këshillim të mëtejshëm ligjor. Avokatët e programit ligjor, pasi shqyrtuan dokumentacionin e paraqitur dhe në përputhje të legjislacionit në fuqi, u konstatua se bazuar në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, VKM nr.618, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar” “Pika 1. Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga



Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAK), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar”, ankuesja ka plotësisht të drejtë të kërkojë 2-fishin e pagesës të AK (16 500 lek udhëzimi nr. 1959 datë 19.09.2006 pika 2) duke qënë se ajo frekuenton shkollën e mesme dhe legjislacioni i sipërpërmendur e garanton këtë të drejtë.

A.L u vu në dijeni me mundësitë ligjore që parashikon ligji nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” për

rastin në fjalë, si dhe u asistua nga Avokatët e programit ligjor, në plotësimin e dokumentacionit dhe paraqitjen e tyre pranë seksionit të ndihmës ekonomike dhe të përkujdesjes shoqërore të Minibashkisë Laprakë, duke mundësuar që A.L të përfitonte 2-fishit e pagesës së AK bazuar në VKM nr.618, datë 7.9.2006.

**Av. Entila Zyba
Kordinatore Programi
Ligjor FSHDPAK
Tiranë**

Personat që nuk dëgjojnë kanë nevoja të ndryshme, por në mungesë të interpretëve komunikimi me botën është i vështirë. Në një moment të vetëm që një person që nuk dëgjon shtrohet në spital, komunikimi me mjekun është shumë i vështirë.

Po kështu edhe gratë që nuk dëgjojnë, kur janë shtatzana duhet të kuptojnë shumë mirë të kujdesen për vete dhe fëmijën. Gjithashtu, në procese gjyqësore ndaj tyre merren

tre vjet. Kreu i ANAD, z. Eduard Ajaz duket optimist teksa i tregon me lëvizje duarsh interpretes, e cila më pas na i përkthen në tinguj dhe fjalë, detajet e projektit më të fundit të tyre, mbështetur nga Ministria e Jashtme Finlandeze dhe organizata e personave që nuk dëgjojnë në të njëjtin shtet. Pasi kanë zbatuar një sërë projektesh të mëparshme për mbështjetjen e organizatës, avokatisë për të drejtat e të gjithë personave që nuk dëgjojnë dhe kërkimit e mbledhjes së gjuhës së shenjave shqipe më të

shenjave, duke menduar edhe për pagesën e tyre.

Është shumë e nevojshme që ne të kemi interpretë të gjuhës së shenjave në gjykatë, në spital. Ne do të ofrojmë shërbime të interpretimit të lajmeve në gjuhën e shenjave edhe në një nga televizionet publike”, thotë Eduardi nëpërmjet interpretes së tij, Nikoleta Spahi. Ministria e Punës ka dhënë “ok” për të filluar procedurat, në mënyrë që shteti të marrë përgjegjësinë e tij për të gjithë pagesën e shërbimeve të interpretimit në Shqipëri.

ANAD do të ofrojë trajnimet e para për 20 interpretët e ardhshëm. Personat që nuk dëgjojnë do të ndjekin edhe lajmet në televizion

Apeli, në gjykata e spitale të ketë interpretë të gjuhës së shenjave për personat që nuk dëgjojnë

vendime jo të sakta për vetë faktin se nuk ka një komunikim shumë të mirë. Në këto kushte, komuniteti i njerëzve që nuk dëgjojnë kërkon nga shteti që të vendosë interpretë të gjuhës së shenjave në disa institucione kryesore publike, siç janë gjykatat dhe spitalet. Madje edhe pagesa për këto shërbime duhet të përballohet nga shteti.

INTERPRETET E PARE TE GJUHES SE SHENJAVE

Shoqata Kombëtare e Personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri, ANAD është duke i paraprirë një drafti përfundimtar për këtë çështje me trajnime që do të zgjasin

përdorshme nga komuniteti i njerëzve që nuk dëgjojnë, këtë vit kanë nisur zbatimin e projektit të trajnimeve për interpretë të gjuhës së shenjave shqipe. Për herë të parë në vendin tonë, pas tre vitesh, në 2009 do të dalin 20 interpretë të gjuhës së shenjave shqipe, të cilët do të pajisen edhe me çertifikata, në fund të trajnimit. “Ne nuk kemi interpretë të gjuhës së shenjave shqipe.

Kjo është hera e parë që ne zbatojmë një projekt për trajnime të interpretëve të gjuhës së shenjave. Ne do të bëjmë avokaci me shtetin që të njohë interpretët e gjuhës së

NJE DEGE PER INTERPRET NE FAKULTET

Në departamentin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja mund të ekzistojë një degë e veçantë ku personat që dëgjojnë, shkojnë dhe marrin njohuri të gjuhës së shenjave. “Përderisa ne nuk kemi interpretë, ne nuk kemi se si të veçojmë një draft, ta përgatisim dhe të themi që ne duam këtë shërbim. Në momentin që ne do të mbarojmë trajnimin trevjeçar atëherë do të flasim konkretisht. Është shumë e rëndësishme, sepse duhet të hedhim hapat e parë që personat që nuk dëgjojnë të fillojnë të marrin sa më shumë njohuri për gjuhën e shenjave. Vetëm në këtë mënyrë

ne mund të kemi sa më shumë interpretë”, na tregon Eduardi. Trajnimi përmban informacion rreth intepretimit, përgjegjësitë e interpretit, gjuha e shenjave, gramatika dhe njohja e librit në gjuhën e shenjave dhe videokaseta në gjuhën e shenjave.

Eduardi rrëfen se numri i personave që kanë kontaktuar ANAD-in ka qenë 40. Ishte shumë e vështirë gjithësesi që të kishte edhe persona nga provinca në këto trajnime, por ndërgjegjësimi i personave është shumë i vogël. Ndërsa nevojat janë shumë të mëdha. “Në Shqipëri janë rreth 3 mijë persona që nuk dëgjojnë, numri kaq i vogël i interpretëve të rinj është e padiskutueshme që është i pamjaftueshëm, por megjithatë ky është fillimi”, tregon interpretja. Pas marrjes së certifikatave nga ANAD do të mundësohet edhe njohja nga Ministria e Punës, në mënyrë që të funksionojë rregullisht. Duke pasur një certifikatë interpreti mund të shkojë në çdo lloj institucioni shtetëror dhe të fillojë punë si interpret i gjuhës së shenjave.

DYERT E MBYLLURA PËR PERSONAT QË NUK DËGJOJNË

Problemet nuk mbarojnë me kaq. Punësimi për personat që nuk dëgjojnë dhe mundësitë janë të pakta.

Gjëra që janë diskutuar gjithmonë, por ndërgjegjësimi i shoqërisë është shumë i vogël dhe në rastin e parë që një person që nuk dëgjon tenton që të shkojë të kërkojë një punë është komplet i injoruar nga personat e tjerë. “Ne jemi shumë afër me Kosovën, por

kemi shumë ndryshime në krahasim me to. Aty personat që nuk dëgjojnë gëzojnë një status, punë të drejta, ndërkohë që te ne situata është ndryshe dhe qeveria jonë është shumë indiferente dhe as që tenton të hedhë ndonjë hap për përmirësimin e kësaj situatë”, tregon interpretja. Problem tjetër është fakti se këta persona janë të papunë për shkak të mosarsimit të duhur, prandaj rreth 80 për qind e tyre janë pa punë. Duhet të bëhet shumë në drejtim të ndërgjegjësimit të personave rreth këtij komuniteti, sepse edhe vetë familja shpesh nuk mund të bëjë asgjë.

“Pas aprovimit që i është bërë bashkëpunimit me organizatën, nga ish-ministri i Arsimit, Ethem Ruka, sot ka rënë në një qetësi totale dhe nuk duan të marrin asnjë lloj informacioni rreth kërkesave që ju shprehim apo problemeve, ajo është një derë e mbyllur”, thotë interpretja.

Madje, edhe ndihma ekonomike mujore nuk është e mundur t’u sigurohet, veç rastit kur ata deklarohen me probleme mendore. Dhe gjithçka që mbetet të shpresojnë është një dorë e shtrirë nga familja dhe të afërmit, sepse shteti është më tepër sesa sy dhe veshëmbyllët ndaj probleme të këtij komuniteti.

**Brikena Demiras
Gazetare**

Mbeshtetje për personat me aftësi të kufizuar në rajonin e Shkodrës

Interviste me znj. Marita Sopi, koordinatore e Qendres se Shanseve te Barabarta, Shkoder, program i FSHDPAK

Diversiteti është pjesë e jetes, por për asnjë çast, nuk duhet të harrojmë se që nga momenti kur vime në jetë, vetëm diçka ruan të njëjten vlerë; e drejta e lirisë dhe e të qenit i barabartë si gjithë të tjerët.

Problematika e aftësisë së kufizuar ka filluar të rritet dita-ditë në sytë e shoqërisë, ku respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe integrimi i tyre në jetën e përditshme përben një strategji me vehte. Dhe pikërisht, Qendra e Zhvillimit të Shanseve të Barabarta, që prej një viti realizon integrimin e personave me aftësi të kufizuar në mbrojtje të respektimit të të drejtave të tyre në qytetin e Shkodrës. Për më tepër, intervista me zj. Marita Sopi, koordinatore projekti pranë kësaj qendre, jep informacion të hollësishëm për aktivitetin e kësaj qendre:

Cila është veprimtaria e Qendres se Zhvillimit të Shanseve të Barabarta dhe çfare ofron ajo për personat e interesuar?

Qendra e Zhvillimit të Shanseve të Barabarta, program i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat (FSHDPAK) e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe i mbështetur nga CORDAID, tashme është ngritur si një



mundesi me shume per t'ju ardhur ne ndihme te gjitha atyre personave qe per shkaqe natyrore apo çdo arsye tjeter jane te privuar ne nje fare menyre nga jeta e rregullt sociale dhe ndihen te perjashtuar nga pjesa tjeter e shoqerise.

Ne fokus te programit te Qendres se Zhvillimit eshte trajtimi i ketyre personave dhe perfshirja e tyre ne nje sere aktiviteteve ne te cilat ofrohen sherbime direkte per vete personat me aftesi te kufizuar, familjaret e tyre dhe persona te tjere qe kane lidhje perfaqesie me personat me aftesi te kufizuar. Gjithashtu qendra promovon te drejtat e PAK si: te drejten per arsim; te drejten per punesim; te drejten e kujdesit shendetesor; informimit; te drejten e mbeshtetjes morale e mbi te gjitha, te drejten per t'u respektuar para se gjithash, si njeri, larg paragjykimeve dhe brenda komunitetit.

Pergatitja e PAK, eshte e vlefshme si per zhvillimin ashtu dhe ne perfshirjen e tyre, ne nje shoqeri te sukseshme. Cilat kane qene objektivat kryesore gjate ketij viti ne kete drejtim dhe si eshte vepruar ne permbushjen e tyre?

Deri tani eshte bere dhe po behet nje pune mjaft e mire ne drejtim

te permbushjes se objektiveve te projektit dhe ne nxitjen e zhvillimit te programit. Nje nder objektivat kryesore eshte dhe krijimi i mbeshtetjes se nevojshme, duke siguruar perfshirjen e 120 personave me aftesi te kufizuara mendore ne arsim, punesim, aktivitete argetuese dhe krijuese permes manaxhimit te rasteve. Zhvillimi i trajnimeve me prinderit e femijeve me aftesi te kufizuara apo te target grupeve te tjera; aktivitete kulturore; perzgjedhja e femijeve per t'u integruar ne shkolle etj, bejne pjese ne sfidat e ketij misioni.

Qendra e Zhvillimit te Shanseve te Barabarta e shtrin veprimtarine e saj ne disa fusha te rendesishme veprimi ku synohet jo vetem trajtimi i personave me aftesi te kufizuar por edhe identifikimi i tyre, dhe me pas vleresimi i nevojave dhe suportit ne aspekte te ndryshme.

Gjate vitit te kaluar, prane kesaj qendre jane regjistruar 200 vizita, ku persona te ndryshem i jane drejtuar qendres per mbeshtetje sociale, juridike, ekonomike etj.

Gjithashtu nje linje e rendesishme e programit te Qendres eshte bashkepunimi me zyrat ne nivel lokal pergegjese

per kete kategori. Mjaft e rendesishme eshte paraqitur puna me shkollat ku gjate vitit te kaluar, jane integruar dhjete femije me aftesi te kufizuara ne klasat e para dhe nje pjese e mire mbeten nen vezhgim, si kontigjent per t'u integruar me pas.

Ofrimi i trajnimeve per mesuesit e shkollave te cilet kane femije me nevoja te veçanta, femije me aftesi te kufizuar mendore; ofrimi i trajnimeve per bashke-moshatare nxenes te cilet perfshihen ne te njejtin ambient me femijet me aftesi te kufizuar mendore ku nje rol te rendesishem ze mbeshtetja e femijeve me aftesi te kufizuar nga femijet e tjere, kane qene dhe vazhdojne te jene pika te rendesishme ne zbatimin e projektit.

Punesimi i personave me aftesi te kufizuar eshte nje aspekt tjeter ku fokusohet veprimtaria e Qendres. Duke ju referuar legjislacionit per punen verehet se nje trajtim i veçante i kushtohet pikerisht kesaj kategorie personash. Nuk eshte aspekt i ri fakti qe personat me aftesi te kufizuar, krahas arsimit baze qe marrin ne shkolla speciale apo te zakonshme, kane arritur te pergatiten dhe te perfshihen sukseshem ne tregun e punes. Pervoja ka treguar se si pergatitja, si dhe gjetja dhe ruajtja e vendit te punes nuk eshte e lehte.

Megjithate, sot gjithnje e me te pakte, jane ato qe mbrojne idene se personat qe paraqesin prapambetje mendore te lehte (koeficient intelektual 70/50) duhet te grupohen me vehte duke qene se pergatitja per pune e PAK, ndikon shume ne zhvillimin e tyre fizik, u rrit besimin ne vetvehte, si dhe mundeson integrimin e tyre te plote ne shoqeri.

Nje objektiv i rendesishem i projektit eshte dhe Asistenca Ligjore Falas per te gjithet. Ç'fare mund te na thoni rreth saj?

Prane Qendres se Zhvillimit te Shanseve te Barabarta ushtron veprimtarine programi i Avokatise dhe Asistences Ligjore Falas, mbeshtetur nga Komiteti Suedez i Helsinkit per mbrojtjen e te drejtave te njeriut per te gjithet personat me aftesi te kufizuar dhe familjaret e tyre ne rajonin e Shkodres.

Ky program ka ne objekt te veprimtarise se tij dhenien e konsulences ligjore dhe mbrojtjen avokatore falas ne sistemin gjyqesor, per te gjithet personat me aftesi te kufizuar dhe familjaret e tyre, permiresimin e kuadrit ligjor dhe sensibilizimin e komunitetit per te krijuar nje mjedis shoqeror te barabarte

Permes programeve qe ky fondacion zhvillon, synohet te krijohet nje imazh i ri i trajtimit te çeshtjeve te aftesise se kufizuar duke u bere njekohesisht dhe operatori kryesor ne vend i rekomandimeve dhe dokumentave nderkombetare ne kete fushe, te cilat orientojne nevojen per ofrimin e sherbimeve bashkekohore ne funksion te zbatimit te te drejtave te personave me aftesi te kufizuar.

Fatjona

ne shkolle, si gjithe te tjeret...

Kur prinderit e Fatjones trokiten prane Qendres se Zhvillimit te Shanseve te Barabarta nuk e dinin se ajo dite dhe te tjerat qe do pasonin do te mbeteshin te paharruara, duke i ofruar zgjidhje konkrete ne edukimin e vajzes se tyre.



Ne fakt, Fatjona qe ne lindje vuante nga nje semundje e cila e kushtezonte ne levizje dhe mund te demtonte integrimin e saj ne shkolle, ne shoqeri dhe ne jete.

Te qenit prinder sjell gjithnje pergjegjesi. Megjithate, te jesh prind i nje femije me aftesi te kufizuara, do te thote shume me teper, m. q. se vemendja, perkushtimi dhe mbi te gjitha pergjegjesite jane me te medha. Gjate diskutimeve me bordin e prinderve te femijeve me aftesi te kufizuara qe zhvillohen prane qendres sone si dhe kontaktit me personat e ndryshem qe i drejtohen per ndihme kesaj qendre, arrin te kuptosh veshtiresite qe keta prinder ndeshin ne rritjen dhe edukimin e femijeve te tyre, sakrificat, perballjen me paragjykimet.

Megjithate bashkeshortet Nikaj qe ne takimin e pare, transmetuan nje impakt pozitiv prane stafit te kesaj qendre me optimizmin dhe aftesine per t'i percjelle Fatjones deshiren per te mesuar dhe per te qene e pavarur ne jete.

Gjate bisedes me prinderit, si dhe me pas duke marre te dhena mbi femijen, ne mesuam qe Fatjona banonte se bashku me prinderit ne fshatin e Dobracit, ishte femija i dyte ne familje dhe sapo kishte mbushur moshen per te hyre ne klase te pare. Duke shfletuar me pas albumin me foto, verehej fare mire, qe Fatjona, megjithese nje femije i brishte e i ndrojtur, rrezatonte çiltersi ne dy syte e mbushur

plot jete. Vajza per tre vite me radhe kishte frekuentuar kopeshtin e Dobracit, ku ne saje te kujdesit te prinderve dhe te edukatoreve aktivizohej vazhdimisht ne veprimtari te ndryshme çlodhese, argetuese dhe kulturore.

Megjithate, integrimi vazhdonte te ishte nje pobleem prezent tek prinderit duke qene se edukimi i femijes ne nje institucion gjithperfshires, siç eshte shkolla normale kishte veshtiresite e veta per shkak te aftesise se kufizuar ne te levizur.

Duke patur parasysh kushtet specifike, edhe pse integrimi i Fatjones perbente nje sfide, stafi i qendres u vu ne levizje per te realizuar nje objektiv te rendesishem: arsimin gjithperfshires te dhjete femijeve me aftesi te kufizuara, ne grupin e te cileve bente pjese dhe Fatjona.

Vogelushja u testua prane qendres se bashku me femijet e tjere mbi zhvillimin mendor, aftesite e te mesuarit, aftesite sociale, ku ne baze te kriterëve perkatese u vleresua e afte per t'u integruar.

Dita e pare e shkolles ishte per Fatjonen realizimi i nje deshires, ku integrimi i saj u pershendet nga drejtorja e Shkolles 9-vjeçare, Dobrac ne pranine e mesuesve, prinderve, nxenesve si dhe stafit te Qendres se Zhvillimit te Shanseve te Barabarta. Ajo u ndje menjehere mire e mbuluar nga dashuria dhe

perkujdesjet e shoqeve dhe shoqeve te klases. Mesuesja e saj Naime Gruda, tregon se si Fatjona mbeshtetet jo vetem ne procesin mesimor por edhe ne aktivitetet e ndryshme shkollore duke i dhene asaj jo vetem mundesine te zgjeroje njohurite dhe te zhvilloje shprehite praktike por edhe te shoqerohet me femije te tjere, te kontribuojte dhe te vleresohet ne baze te zhvillimit individual, nga dita ne dite. Ne saje te kujdesit te As/ Programit, z. Rrok Daka si dhe mbeshtetjes se Drejtorit te kesaj Shkolle z. Riza Kraja, nxenesja Fatjona Nikaj, megjithese nje femije me aftesi te kufizuara po integrohet gjithnje e me teper ne proceset e edukimit arsimor gjithperfshires. Fatjona eshte nje nder dhjete femijet e integruar ne arsim gjithperfshires, nga Qendra e Zhvillimit te Shanseve te Barabarta te cilet po ndiqen aktualisht, nga nje program i posaçem realizuar nga FSHDPAK. Gjithashtu, paralelisht po punohet qe edhe dhjete femije te tjere te integrohen gjate vitit te ardhshem shkollor, ne menyre qe aftesia e kufizuar te mos jete ne te ardhmen nje pengese ne zhvillimin psiko-social te individit dhe integrimin e PAK ne pune, jete dhe ne shoqeri.

Edlira Grabova
As/ Koordinator e
Qendres se Shanseve te
Barabarta, Shkoder,
FSHDPAK